

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**HLB AUDIT ALBANIA SH.P.K.**

**KREU I**

**THEMELIMI, EMRI, SELIA, OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA**

**Neni 1**

**Themelimi dhe Emri**

- 1.1. Sot, më 20.07.2023, themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin **HLB AUDIT ALBANIA** (këtu e më poshtë referuar si "*Shoqëria*"), në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 1.2. Themeluesit e Shoqërisë janë:
  - (1) HLB Albania Sh.p.k., me seli në Tiranë, Njësia Administrative nr. 5, Rruga Mihal Popi, Vila nr. 8, Tiranë 1019, regjistruar në Regjistrin Tregtar me NIPT M31620028G, përfaqësuar në këtë akt nga përfaqësuesi ligjor Z. Tommaso Marseglia, shtetas shqiptar, lindur më 01.10.1982, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal I21001210N ("*HLB Partner*"). HLB Partner gëzon të drejtën ekskluzive të përdorimit në Shqipëri të markës dhe emërimit HLB që identifikon pjesëmarrjen në rrjetin HLB International;
  - (2) Znj. Doriana Mamillo, shtetase shqiptare, lindur më 30.01.1984, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal I45130031U ("*Ortak Individual*"), e regjistruar në Regjistrin e Audituesve Ligjorë të Republikës së Shqipërisë;
- 1.3. Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 1.4. Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe këtë statut.

**Neni 2**

**Selia**

- 2.1. Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga Muhamet Gjollësja, ndërtesa nr. 43/2, sh/k 1, ap.2 Tiranë.
- 2.2. Shoqëria mund të hapë degë, filiale dhe zyra përfaqësimi në Shqipëri dhe jashtë saj dhe mund të ushtrojë veprimarinë e saj edhe në vendndodhje të tjera brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 3**

**Objekti i Veprimtarisë**

- 3.1. Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj kryerjen e auditimit ligjor të pasqyrave financiare, individuale dhe/ose të konsoliduara të shoqërive tregtare dhe subjekteve të tjera juridike, si dhe shërbime *due diligence*.

- 3.2. Shoqëria mund të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive që kanë objekt të njëjtë a të ngjashëm me të ose, në çdo rast, të dobishëm për realizimin e qëllimeve të Shoqërisë, si dhe të bashkëpunojë me shoqëri dhe subjekte të tjera, përfshirë në formën e binjakëzimit.
- 3.3 Në ushtrimin e aktivitetit të saj, Shoqëria mund të kryejë të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacionet financiare dhe industriale, që do të vlerësohen prej saj të nevojshme ose të dobishme për realizimin e objektit të Shoqërisë.
- 3.4. Shoqëria do të pajiset, sipas rastit, me të gjitha autorizimet dhe lejet e nevojshme, në bazë të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi për ushtrimin e aktivitetit të saj të rregullt ekonomik.

#### **Neni 4**

#### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

### **KREU II**

### **KAPITALI**

#### **Neni 5**

#### **Kapitali Themeltar dhe Ortakët**

- 5.1. Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e Shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre si më poshtë:
- (1) Ortaku themelues HLB ALBANIA Sh.p.k. është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë nominale të përgjithshme prej 49.000 (dyzetë e nëntë mijë) Lek, që përfaqëson 49% të kapitalit themeltar të Shoqërisë;
  - (2) Ortaku themelues Znj. Doriana Mamillo është zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë nominale të përgjithshme prej 51.000 (pesëdhjetë e një mijë) Lek, që përfaqëson 51% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
- 5.2. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë.

#### **Neni 6**

#### **Transferimi i Kapitalit**

- 6.1. Kuotat janë të transferueshme midis ortakëve dhe në favor të palëve të treta me kusht që Shoqëria të plotësojë në çdo moment kërkesat e legjislacionit shqiptar në fuqi për auditimin ligjor në lidhje me pjesëmarrjen në kapital dhe drejtimin e Shoqërisë.
- 6.2. Në rast se njëri nga ortakët synon të transferojë kuotën e tij ose të tërhiqet nga Shoqëria, ai është i detyruar t'ia ofrojë dhe transferojë kuotën e tij ortakut tjetër ose një personi të autorizuar prej tij, dhe ky i fundit ka detyrimin korrespondues të blerjes së kuotës, kundrejt një çmimi të barabartë me vlerën nominale.
- 6.3 Në rast të largimit nga jeta të ndonjërit nga ortakët, trashëgimtarët e tij/saj nuk do ta zëvendësojnë atë si ortak në Shoqëri për qëllime të ushtrimit të aktivitetit. Ortaku që mbetet në Shoqëri ka të drejtën të blejë kuotën e ortakut të larguar me një çmim të barabartë me vlerën nominale dhe trashëgimtari/trashëgimtarët kanë detyrimin korrespondues të shesin kuotën e trashëguar në favor të ortakut që mbetet ose të një personi të tretë të autorizuar prej tij kundrejt një çmimi të barabartë

me vlerën nominale.

- 6.4. Pikat 6.2. dhe 6.3. të këtij neni konsiderohen si marrëveshje paraprake mes ortakëve për shitblerjen e kuotës dhe kalimi i saj do të kryhet në përputhje me ligjin. Çdo transferim i kryer në kundërshtim me rregullat dhe kufizimet e këtij neni do të konsiderohet i pavlefshëm dhe Ortaku transferues do të jetë përgjegjës ndaj ortakut/ortakëve të tjerë dhe Shoqërisë për dëmin e shkaktuar.
- 6.5. Në rast largimi për çdo arsye të ortakut HLB Partner, Shoqëria humbet të drejtën e përdorimit të markës dhe emërtimit HLB. Ortaku/ortakët që mbeten në Shoqëri kanë detyrimin e ndryshimit të emërtimit të Shoqërisë dhe njoftimit të këtij ndryshimi në marrëdhënie me të tretët.

### **KREU III**

#### **ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 7**

##### **Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve**

- 7.1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, të marra në përputhje me ligjin dhe me dispozitat e këtij Statuti, janë të detyrueshme për të gjithë ortakët.
- 7.2. Asambleja e Përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- (a) përcaktimin e politikave tregtare dhe ekonomike të Shoqërisë dhe mbikqyrjen e zbatimit të tyre nga administratorët;
  - (b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - (c) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - (d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "b" dhe "c" më sipër;
  - (e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - (f) ndryshimet e statutit;
  - (g) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
  - (h) shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;
  - (i) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
  - (j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji ose statuti.
- 7.3. Përveç nëse është parashikuar ndryshe në këtë statut, të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve miratohen me votën e favorshme të ortakëve që përfaqësojnë të paktën 75% të kapitalit themeltar.

#### **Neni 8**

##### **Mënyra e Thirrjes së Asamblesë**

- 8.1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mblidhet sa herë të jetë e nevojshme për interesat e Shoqërisë apo kur kërkohet nga ligji, në çdo rast, jo më pak se 1 (një) herë në vit.
- 8.2. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me postë të regjistruar ose me postë



elektronike dërguar ortakëve në adresat që ata i kanë njoftuar Shoqërisë, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë. Në rast se të gjithë ortakët janë dakord për të marrë vendime, Asambleja e përgjithshme mund të mblidhet dhe të marrë vendime të vlefshme edhe në rast se nuk është thirrur sipas këtij paragrafi.

- 8.3. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes duhet të përmbajë rendin e ditës dhe të tregojë vendin, datën dhe orën e zhvillimit të mbledhjes së Asamblesë.
- 8.4. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve mund të mbahet edhe jashtë selisë së Shoqërisë, brenda Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj.
- 8.5. Mbledhja e përgjithshme e ortakëve mund të mbahet edhe me mjete elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve dhe t'u mundësohet të ndjekin bisedën dhe të ndërhyjnë në kohë reale lidhur me trajtimin e çështjeve në rend të ditës.
- 8.6. Ortakët kanë të drejtë të marrë pjesë në mbledhje, personalisht ose nëpërmjet përfaqësimit nga një person tjetër, mbi bazën e një akti përfaqësimi. Akti i përfaqësimit vlen në çdo rast vetëm për një mbledhje të Asamblesë, përfshirë të gjitha thirrjet e saj.
- 8.7. Asambleja drejtohet nga një kryetar i emëruar nga ortakët e pranishëm. Kryetari i Asamblesë zgjedh edhe një sekretar për mbajtjen e procesverbalit, i cili mund edhe të mos jetë nga radhët e ortakëve.
- 8.8. Procesverbalet e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve nënshkruhen nga kryetari dhe mbajtësi i procesverbalit.
- 8.9. Të gjitha njoftimet dhe komunikimet që Shoqëria u drejton ortakëve, sipas këtij statuti, do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen ortakëve në adresat, përfshirë ato elektronike, të deklaruara prej tyre pranë administratorit të Shoqërisë.

## **Neni 9**

### **Administrimi**

- 9.1 Shoqëria do të administrohet nga një ose më shumë administratorë, të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme e ortakëve. Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron me shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht Shoqërinë.
- 9.2 Afati i emërimit të administratorëve është për një periudhë kohore prej 2 (dy) vitesh, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 9.3. Asambleja e Përgjithshme e ortakëve mund të shkarkojë administratorët në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Marrëdhëniet e administratorëve me Shoqërinë do të rregullohen nga Ligji 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, duke përjashtuar shprehimisht zbatimin e Kodit të Punës në këto marrëdhënie.
- 9.4. Administrori i parë i Shoqërisë do të jetë:
  - Znj. Dorian Mamillo, shtetase shqiptare, lindur më 30.01.1984, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal I45130031U.

## **Neni 10**

### **Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratorit**

10.1 Administratorët kanë detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

- (a) kryejnë të gjitha veprimet për administrimin e veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar

politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;

- (b) përfaqësojnë Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët;
  - (c) kujdesen për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të Shoqërisë;
  - (d) përgatisin dhe nënshkruajnë pasqyrat financiare vjetore, bilancin e konsoliduar (nëse është rasti), raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente për miratim përpara Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
  - (e) krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e Shoqërisë;
  - (f) kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;
  - (g) raportojnë përpara Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve për zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e Shoqërisë;
  - (h) kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në këtë statut.
- 10.2. Administratorët mund të emërojnë përfaqësues me prokurë të posaçme vetëm për kryerjen e veprimeve specifike dhe të përcaktuara qartë, në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre nga ky statut dhe me miratimin paraprak të HLB Partner.
- 10.3 Administratori / administratorët e Shoqërisë kanë detyrimin të marrin miratimin paraprak të HLB Partner në lidhje me veprimet si vijon:
- (a) pranimin e klientëve të rinj;
  - (b) lidhjen e kontratave a marrëveshjeve të çdo lloji që rezultojnë në detyrime në Shoqërinë për një vlerë më të madhe se 5.000 (pesëmijë) Euro për çdo shërbim, furnizim apo send a pasuri;
  - (c) për kryerjen e veprimtarive promocionale dhe komunikimit të Shoqërisë, përfshirë përmes rrjeteve sociale apo faqeve web.
- 10.4. Në rast se një administrator nuk respekton kufijtë e mandatit të tij, çdo vendim a veprim i marrë në kundërshtim me këtë nen do të konsiderohet i pavlefshëm me fuqi prapavepruese dhe administratori do të jetë përgjegjës për çdo pasojë që do të rezultojë nga këto veprime, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, detyrimin e shpërblimit të dëmeve të shkaktuara Shoqërisë, ortakeve apo palëve të treta.

## KREU IV

### VITI FINANCIAR - SHPËRNDARJA E FITIMEVE

#### Neni 11

##### Viti Financiar

Viti financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.

#### Neni 12

##### Shpërndarja e Fitimeve

Asambleja e ortakëve miraton pasqyrat financiare të Shoqërisë të paraqitura nga administratori,

brenda 3 (tre) muajve nga përfundimi i i vitit financiar dhe, mbi këtë bazë, do të marrë të gjitha vendimet përkatëse mbi shpërndarjen e fitimit dhe fondet rezervë.

## **KREU V**

### **PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

#### **Neni 13**

##### **Prishja**

Shoqëria mund të priset me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve, në rastet e parashikuara nga ligji.

#### **Neni 14**

##### **Likuidimi**

Në rast prishjeje, Shoqëria duhet të likuidohet. Asambleja e Përgjithshme e ortakëve emëron një ose disa likuidues të cilët do të paraqesin raportin përfundimtar të likuidimit mbi asetet dhe detyrimet e Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme të likuidimit.

## **KREU VI**

### **DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 15**

##### **Ligji i Zbatueshëm**

Për të gjitha çështjet që nuk gjejnë rregullim të posaçëm në këtë statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare.

#### **Neni 16**

##### **Të Ndryshme**

Ky Akt Themelimi dhe Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar HLB AUDIT ALBANIA Sh.p.k. hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

## **ORTAKËT**

**HLB ALBANIA SH.P.K.**

Tommaso Marsaglia



**DORIANA MAMILLO**

Doriana Mamillo

